
Ligji Nr. 02/L-15

**PËR KOMISIONIN E PAVARUR TË MEDIAVE
DHE TRANSMETIMIN**

Kuvendi i Kosovës,

Bazuar në Rregulloren nr. 2001/9 të dt.15 maj 2001 Mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, veçanërisht Kreu 5.4, 5.7, 9.1.26 (a), 9.3.2 dhe 11.1(d),

Miraton:

**LIGJIN PËR KOMISIONIN E PAVARUR TË MEDIAVE
DHE TRANSMETIMIN**

**KREU I
PËRKUFIZIMET**

Neni 1

Për qëllime të këtij ligji do të zbatohen përkufizimet vijuese:

“Transmetim” do të thotë emetim burimor i programit me valë difuzive nëpërmjet të transmetuesit tokësor, kabllovik, satelitor ose me pajisje të tjera elektronike, të koduar apo të pakoduar, që i destinohen për shfrytëzim publikut që pranohen me radio, televizion ose pajisje elektronike të veçanta për emetim, duke mos përfshirë komunikimet individuale;

“Transmetues” do të thotë personi fizik apo juridik që ka përgjegjësi redaktuese për përbërjen e shërbimeve programore televizive dhe të radios për praninë nga publiku i përgjithshëm dhe i transmeton ato apo bën që ato të transmetohen të tëra e të pandryshuara nga pala e tretë.

“Plani i frekuencave të transmetimit” do të thotë plani i frekuencave të radio transmetimit ose të transmetimit televiziv të caktuara nga autoriteti kompetent qeveritar për postë dhe telekomunikim në Zyrën e Komisionerit të përkohshëm të mediave dhe që drejtohet nga Komisioneri i përkohshëm i mediave;

“Spektri i frekuencave të transmetimit” do të thotë frekuencat që janë në dispozicion për caktimin e radio transmetueseve dhe transmetuesve televizivë për përdorim të tyre në pajtueshmëri me standardet e Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit. Ai nuk përfshin frekuencat që i përdorin:

Ligji mbi Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim është aprovuar nga Kuvendi më 21 prill 2005 dhe është shpallur nga PSSP më 08 korrik 2005. Ky version i Ligjit, i përgatitur nga Komisioni i Pavarur për Media inkorporon amendamentet e shpallura nga PSSP në tekstin e aprovuar nga Kuvendi. Prandaj, ky tekst është teksti operativ i Ligjit.

- a. bartësit e rëndomtë të telekomunikimit, për shembull, për të dhënat, për audio dhe video materiale, siç janë telefoni dhe pejxheri; si dhe
- b. transmetimet që nuk i përkasin opinionit të gjerë siç janë: policia, ushtria dhe kanalet e emergjencës;

“**Reklamim**” do të thotë çfarëdo shpallje publike e transmetuar me pagesë apo shpërblim të ngjashëm, për qëllime të vetë promovimit, që është i destinuar për promovimin e shitjes, blerjes apo qiradhënies së një prodhimi apo shërbimi, për ta shtyrë përpara ndonjë ide apo çështje, ose për të shkaktuar disa efekte tjera të dëshiruara nga reklamuesi apo nga vet transmetuesi;

“**Sponsorim**” do të thotë kontribut i ndonjë personi fizik apo juridik që nuk është i angazhuar në veprimtaritë transmetuese apo në produksionin e veprave audio-vizuale, në financimin direkt apo indirekt të ndonjë programi, por që synon promovimin e emrit, shenjës, imazhit apo aktiviteteve të atij personi;

“**Teleshoping**” do të thotë transmetimi i drejtpërdrejtë i ofertave publikut me qëllim të ofrimit të mallrave apo shërbimeve, duke përfshirë patundshmërinë, të drejtat apo detyrimet, si shpërblim për pagesë;

“**Komunitet**” do të thotë çdo banor apo grup njerëzish të Kosovës që i përkasin grupit të njëjtë etnik, fetar apo gjuhësor;

“**Transmetues privat**” do të thotë çdo transmetues i licencuar qoftë si individ, OJQ apo biznes tregtar;

“**Transmetuesi Publik**” nënkupton cilindo transmetues të Radios dhe Televizionit në Kosovë i themeluar posaçërisht me ligj për të vepruar si transmetues i shërbimit publik përfshirë transmetuesin publik të themeluar me anë të Rregullores së UNMIK-ut 2001/13;

“**Banor i Kosovës**” do të thotë personi i regjistruar në Regjistrin Civil Qendror si banor i përhershëm i Kosovës në pajtim me Rregulloren nr. 2000/13 të UNMIK-ut të datës 17 mars 2000, mbi Zyrën Qendrore të Regjistrimit Civil.

KREU II FORMIMI I KOMISIONIT TË PAVARUR TË MEDIAVE

PJESA A: KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE

Autorizimet e përgjithshëm Neni 2

2.1. Në bazë të këtij Ligji themelohet Komisioni i Pavarur i Mediave (tash e tutje: “KPM”).

2.2. KMP-ja është organ i pavarur nga ndikimet politike, të çfarëdo lloji qofshin ato, për ushtrimin e përgjegjësisë dhe të funksioneve të saj të përcaktuara në bazë të këtij Ligji dhe të ligjeve tjera të zbatueshme në Kosovë në pajtueshmëri me nenin 11.1 (d) të Kornizës Kushtetuese.

2.3. KPM-ja përbëhet nga tri organe të veçanta:

- a. Këshilli,
- b. Zyra e Shefit Ekzekutiv dhe
- c. Bordi i Ankesave për Media.

2.4. KPM-ja rregullon Spektrin e Frekuencave Transmetuese në Kosovë si dhe licencon transmetuesit publik dhe privat për t'i përdorur ato, në pajtueshmëri me praktikën më të mira Evropiane, duke përfshirë, pos të tjerash, zbatimin e politikës së transmetimit që do ta përcaktojë Këshilli (tash e tutje: "Politika e transmetimit").

2.5. KPM-ja gjithashtu do të nxjerrë rregulla dhe rregullore, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e përshkruara me nenin 2 të këtij ligji.

2.6. Komisioni është autoriteti i vetëm në territorin e Kosovës përgjegjës për menaxhimin, rregullimin dhe caktimin e resurseve të spektrit të frekuencave të transmetimit dhe për dhënien e licencave dhe mbledhjen e taksave për shfrytëzimin e frekuencave transmetuese. Autorizimet dhe kompetencat e Agjencisë së Rregullatorit për Telekomunikim ("ART") nuk përfshijnë transmetimin apo transmetuesit siç përkufizohen në nenin 1 të këtij Ligji. Zyra e kryeshefit ekzekutiv (të quajtur "Kryeshef Ekzekutiv" kudo në Ligj) koordinon menaxhimin e spektrit të frekuencave të transmetimit me ART-në.

PJESA B: KËSHILLI

Funksionet e Këshillit Neni 3

3.1. Në konsultim me Zyrën e Shefit Ekzekutiv dhe me palët e tjera të interesuara, në pajtim me këtë ligj, Këshilli, sipas nevojës, krijon dhe ndryshon politikën e transmetimit.

3.2. Politika e transmetimit duhet të jetë në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtarisht të transmetimit dhe të të drejtave të njeriut, duke respektuar plotësisht demokracinë dhe sundimin e ligjit si dhe mbrojtjen e lirisë së shprehjes. Përveç kësaj, politika e transmetimit do të jetë në pajtim të plotë me legjislacionin përkatës të Kosovës.

3.3. Politika e transmetimit, e përcaktuar nga Këshilli, duhet të promovojë produksionin vendor, të promovojë shërbime cilësore të shumëllojshme duke përfshirë shtrirjen gjeografike në mënyrën më të mirë të mundshme për t'i shërbyer të gjitha komuniteteve në Kosovë, të nxisë programe edukative cilësore, të promovojë qëndrueshmëri financiare dhe cilësi teknike të transmetimit në Kosovë, të promovojë përdorimin e teknologjisë së re, si dhe të reagojë në të drejtën e publikut për të ditur dhe për t'u njoftuar përmes promovimit të programeve të sakta dhe informative. Gjithashtu duhet të promovohet transmetimi i programeve vendore, edukative sidomos për të rinjtë. Programet do të pasqyrojnë kërkesat për barazi mes qytetarëve dhe komuniteteve. Po ashtu, përmes politikës së transmetimit, duhet të krijohet zbatimi i dispozitave të tilla të cilat do ta parandalojnë monopolizimin e transmetimit në Kosovë për të promovuar një konkurrencë të drejtë transmetuese.

3.4. Në konsultim me Zyrën e Shefit Ekzekutiv, Këshilli shqyrton propozimin për buxhetin vjetor të KMP-së dhe përmes Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë ia dërgon atë Qeverisë së Kosovës për miratimin e tij përfundimtar. Buxheti duhet të ofrojë mjete për

honorare, shpenzime të arsyeshme, mbështetje të duhur dhe shpenzime administrative, shpenzime të arsyeshme kapitale, të sigurojë personelin, shpenzimet e programit, kapacitetet, shpenzime tjera rrjedhëse si dhe shpenzimet përcjellëse që kërkohen nga të tri organet e KPM-së, të cilat duhet të jenë në pajtim me procedurat normale të autoritetit qeveritar kompetent për çështjet fiskale.

3.5. Pas aprovimit të buxhetit për Këshillin e KPM-së, Zyrën e Shefit Ekzekutiv dhe Bordi i Ankesave për Media për vitin aktual, nuk mund të ketë reduktime të mëvonshme të fondeve që u janë dhënë në disponim atyre.

3.6. Këshilli duhet të shqyrtojë propozimin e buxhetit vjetor të Bordit të Ankesave për Media, i përgatitur në pajtim me nenin 26, dhe do ta dorëzojë atë për aprovim te autoritetet qeveritare kompetente për çështjet fiskale.

3.7. Në konsultim me Zyrën e Shefit Ekzekutiv, Këshilli do të shqyrtojë çdo vit Planin e frekuencave të transmetimit (tash e tutje: “Plani”) dhe do të bëjë ndryshime të nevojshme. Këshilli duhet ta njoftojë autoritetin qeveritar kompetent për postë dhe telekomunikacion në lidhje me çdo ndryshim të planit.

3.8. Pas konsultimeve me Zyrën e Shefit Ekzekutiv, Këshilli përgatitë dhe i paraqesë Kuvendit të Kosovës, brenda dy muajve pas përfundimit të çdo viti kalendarik, një raport vjetor, duke përfshirë edhe të dhënat e plota në lidhje me përcaktimin dhe zbatimin e politikës së transmetimit, dhënien e liçencave dhe të ankesave, sanksionet që zbatohen dhe vendimet në lidhje me to, aktivitetet financiare, aktivitetet e tjera të transmetimit dhe objektivat e projektimit për vitin e ardhshëm. Raporti vjetor duhet të bëhet publik.

3.9. Këshilli duhet të emërojë Shefin Ekzekutiv në pajtim me nenin 8 të këtij Ligji.

3.10. Të gjitha mbledhjet e Këshillit duhet të jenë të hapura për publikun, dhe të gjitha vendimet e Këshillit duhet të jenë të hartuara me shkrim dhe të bëhen publike brenda dy ditëve të punës pasi të jenë mbajtur mbledhjet.

3.11. Këshilli ka autoritet ekskluziv të aprovojë me shumicë të thjeshtë të votave kushtet për liçencim dhe të vendosë në lidhje me aplikimet për liçencat (përfshi ripërtëritjen e liçencave) si dhe dhënien e të drejtës së përdorimit të frekuencave të Spektrit të Frekuencave të Transmetimit. Këshilli gjithashtu mund të vendosë edhe sanksione bazuar në rekomandimet e Shefit Ekzekutiv.

3.12. Këshilli udhëheq Komisionin sa i përket çështjeve strategjike që kanë të bëjnë me zbatimin e këtij ligji. Këshilli nxjerr akte, udhëzime, politika dhe detyrat që janë të nevojshme për zbatimin e efektshëm të këtij ligji. Duke u bazuar në këshillën dhe rekomandimet e Zyrës së Shefit Ekzekutiv, Këshilli lëshon liçenca dhe i ripërtërin ato, duke iu dhënë subjekteve të autorizuar të drejtën e përdorimit të frekuencave në Spektrin e Frekuencave të Transmetimit dhe është i autorizuar që të vendosë sanksione për shkeljen e rregulloreve të komisionit apo kushteve të liçencës.

3.13. Këshilli pas rekomandimeve të Shefit Ekzekutiv, duhet të nxjerr një Kod të Etikës që do të jetë i aplikueshëm për Këshillin dhe Personelin e Komisionit.

3.14. Në çdo rast kur Këshilli planifikon të nxjerr një akt të veçantë, përkatësisht rregullore me të cilën do të rregullonte raporte të caktuara, është i obliguar që aktet e tilla t’ua vërë në

disponim një spektri të gjerë subjektsh. Publiku dhe palët e interesuara duhet të kenë jo më pak se 14 ditë në disponim për të komentuar draft-aktin. Personeli i Komisionit është i detyruar t'i marrë parasysh mendimet e publikut mbi aktet e propozuara.

3.15. Këshilli pas rekomandimit të Shefit Ekzekutiv, duhet të adoptojë një strategji që i ofron publikut mundësi për qasje në licencat dhe rregulloret e nxjerra nga Komisioni, vendimet publike që rezultojnë nga këto rregullore dhe të gjitha veprimet ekzistuese të ndërmarra nga Këshilli. Përveç kësaj, Komisioni duhet t'i ofrojë mundësinë publikut që të ketë qasje në mbledhjen e dokumentacionit, shënimeve për rastet dhe vendimet e Bordit të Ankesave për Media. Qasja e publikut në dokumentacionin e Komisionit duhet të mbështetet në praktikat më të mira Evropiane, të cilat i referohen lëmisë që rregullohet nga ligjet e informimit.

Përbërja e Këshillit Neni 4

4.1. Këshilli përbëhet nga shtatë (7) anëtarë, prej të cilëve dy (2) janë anëtarë ndërkombëtar, kurse pesë (5) janë anëtarë vendor të Kosovës. Struktura e anëtarëve të Këshillit që janë banorë të Kosovës pasqyron parimin e shumetnicitetit. Me zgjidhjen e statusit politik të Kosovës, numri i anëtarëve të Këshillit mbetet i njëjtë, shtatë (7) ku dy të fundit janë anëtarë vendorë të emëruar në përputhje me procedurat e përshkruara në nenin 4.4 t këtij Ligji.

4.2. Anëtarët ndërkombëtarë të Këshillit emërohen nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP).

- a. Në rastin kur mandati i anëtarit ndërkombëtar të Këshillit përfundon para skadimit të periudhës së emërimit, ose kur anëtari vdes ose jep dorëheqje, PSSP-ja emëron një anëtar të ri brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh. Ky emërim zgjatë për periudhën derisa të skadojë mandati i ish-anëtarit të Këshillit.

4.3. Një (1) anëtarë vendor i Këshillit emërohet dhe caktohet nga Kuvendi i Kosovës.

- a. Procedura e miratuar nga Kuvendi i Kosovës për emërimin e anëtarit vendor duhet të jetë e hapur dhe transparente.
- b. Emërimi duhet të ratifikohet para skadimit të mandatit të anëtarit aktual. (Emërimi i anëtarit fillestar duhet të ratifikohet brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh pas miratimit të këtij ligji.)
- c. Anëtari vendor i këshillit konsiderohet i emëruar kur për të kanë votuar mbi 50% e deputetëve të Kuvendit.
- d. Nëse mandati i anëtarit vendor të Këshillit të emëruar nga Kuvendi përfundon para skadimit të periudhës së emërimit, ose nëse anëtari vdes ose jep dorëheqje, Kuvendi i Kosovës emëron një anëtar të ri brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh. Ky emërim zgjatë për periudhën derisa të skadojë mandati i ish-anëtarit.
- e. Pëlqimi me shkrim i anëtarit se e pranon emërimin do të bashkëngjitet me aktin e emërimit, si dhe deklarata e tij/saj se nuk ka kurrfarë pengesash për emërimin e tij/saj, siç referohet në nenin 4.7 të këtij ligji.

4.4. Katër anëtarë vendor të Këshillit propozohen dhe emërohen si vijon:

- a. Anëtarët vendor të Këshillit (tash e tutje: “anëtarë të Këshillit nga shoqëria civile”) propozohen nga individët dhe organizatat me vendbanim ligjor në Kosovë duke përfshirë por pa u kufizuar në asociacionet e regjistruara të gazetarëve dhe organizatat joqeveritare të përfshira në sferën e mediave, mbrojtjen e lirisë së fjalës dhe të të drejtave të njeriut si dhe përfaqësuesit nga akademia dhe komuniteti juridik, duke e respektuar përfaqësimin gjinor dhe atë të komuniteteve në Kosovë.
- b. Inicimin e procedurës për emërimin e anëtarëve të Këshillit nga shoqëria civile e bën Shefi Ekzekutiv, duke publikuar një ftesë jo më vonë se tre (3) muaj para skadimit të mandatit të anëtarëve të Këshillit nga shoqëria civile. (Si përjashtim të kësaj, për mandatin fillestar të anëtarëve të Këshillit nga Shoqëria Civile të paraparë me këtë ligj, Komisioneri i Përkohshëm i Mediave inicion procedurën e nominimit brenda dy javësh pas miratimit të këtij ligji.)
- c. Ftesa publike duhet të shpallet gjerësisht në mediat e shtypit dhe të transmetimit të Kosovës, në gjuhët zyrtare në Kosovë në të cilën specifikohen kualifikimet e kërkuara për anëtarët e Këshillit në pajtueshmëri me këtë ligj.
- d. Shefi Ekzekutiv i KPM - së brenda 30 ditësh nga lëshimi i ftesës për propozime thërret mbledhjen publike për të shpallur listën e të propozuarve.
- e. Shefi Ekzekutiv i KPM-së duhet që brenda 15 ditësh nga takimi publik t’ia dërgoj një komisioni ad-hoc të mbledhur nga Kryetari i Kuvendit një listë me kandidatët më të kualifikuar, konform kualifikimeve të kërkuara në ftesën për propozime. Lista duhet të përbëhet nga dyfishi i kandidatëve për vendet e lira në Këshill. Komisioni ad-hoc i Kuvendit duhet të përbëhet nga një përfaqësues i secilës parti që është e përfaqësuar në Kuvend. Komisioni duhet të debatojë jo publikisht për të zgjedh, me konsensus, katër anëtarët e Këshillit nga shoqëria civile. Zgjedhja duhet të reflektojë barazinë gjinore, përfaqësimin e komuniteteve në Kosovë si dhe aftësitë dhe ndershmërinë që e kërkon një rregullator i transmetimit.
- f. Komisioni ad-hoc i rekomandon Kuvendit të Kosovës listën për emërimin e anëtarëve të Këshillit, nga shoqëria civile, jo më vonë se dhjetë (10) ditë pas vlerësimit të tyre nga komisioni.
- g. Kuvendi i Kosovës duhet t’i vërtetoj formalisht emërimin e anëtarëve të Këshillit nga shoqëria civile brenda tridhjetë (30) ditësh pasi të jenë paraqitur zyrtarisht nominimet.
- h. Pëlqimi me shkrim i anëtarit të Këshillit nga shoqëria civile lidhur me pranimin e nominimit duhet të bashkëngjitet me nominimin, si dhe deklarata e tij/saj se nuk ka pengesa për emërimin e tij/saj, siç referohet në nenin 4.7 të këtij Ligji.
- i. Në rastin kur mandati përfundon para skadimit të periudhës së emërimit të anëtarit të Këshillit nga shoqëria civile, ose kur një anëtar i Këshillit nga shoqëria civile ka vdekur ose ka dhënë dorëheqje, duhet të vijohet sipas procedurave të specifikuar nën (b)-(h) më lart, me përjashtim që ftesa publike duhet të publikohet 30 ditë pasi të ketë mbetur posti i lirë. Ky emërim duhet të ratifikohet për periudhën derisa të skadojë mandati i anëtarit të përparmë.

4.5. Nëse përfundon mandati i ndonjë anëtari të Këshillit, ose anëtari vdes ose jep dorëheqje, Këshilli mund të marrë vendime të vlefshme edhe para se të bëhet vërtetimi i emërimit të anëtarit të ri. Megjithatë, nëse numri i anëtarëve është më i vogël se 50 % i numrit të anëtarëve të Këshillit Këshilli nuk ka të drejtë të marrë vendime gjersa të mos ketë së paku mbi 50 % të anëtarëve për miratim.

4.6. Personat e përzgjedhur për emërim si anëtar të Këshillit duhet të kenë njohuri relevante dhe përvojë që do t'u bëjë të mundur të japin kontribut të rëndësishëm për funksionet e Këshillit.

4.7. Asnjë person nuk mund të jetë anëtar i Këshillit nëse ai ose ajo:

- a. ka punësim aktiv në shërbimin civil të Kosovës;
- b. mban post publik të zgjedhur;
- c. është anëtar i organit ekzekutiv të një partie politike;
- d. ka interes financiar të drejtpërdrejtë ose përfaqëson këtë interes, ose punon në ndonjë transmetues në punët e telekomunikimit ose të transmetimit;
- e. ka qenë i/e dënuar, pas procesit të duhur në pajtim me standardet e pranueshme ndërkombëtarisht, për krime duke përfshirë dhunën ose punë të pandershme, për të cilën ai ose ajo nuk janë falur zyrtarisht dhe me ligj, ose
- f. është i/e angazhuar në aktivitete që mund të konsiderohen të jenë në kundërshtim me funksionet e Këshillit.

4.8. Emërimi i autoriteteve në Këshill duhet të pasqyrojë shoqërinë civile dhe multietnike të Kosovës si dhe të jenë të përfaqësuara të dyja gjinitë.

Kohëzgjatja e emërimeve në Këshill Neni 5

5.1. Mandati i anëtarëve ndërkombëtarë në Këshill do të jetë si vijon:

- a. mandati fillestar i njërit prej anëtarit ndërkombëtar është tetëmbëdhjetë (18) muaj;
- b. mandati fillestar i anëtarit tjetër ndërkombëtar është dymbëdhjetë (12) muaj;

5.2. Mandatet e pesë (5) anëtarëve të vendit do të jenë si vijon:

- a. Të gjithë anëtarët vendorë të Këshillit emërohen për mandatin prej dy (2) vjetësh.
- b. Si përjashtim nga neni 4.2 (a) i këtij ligji, mandati fillestar i dy (2) anëtarëve të Këshillit nga shoqëria civile është një (1) vit për secilin, që duhet të zgjidhet me short të tërhequr nga Komisioneri i Përkohshëm i Mediave në një takim publik.
- c. Secili emërim i bërë pas emërimeve fillestare është me mandat prej dy viteve.

Shkarkimi nga Këshilli dhe mirësjellja e anëtarëve
Neni 6

6.1. Kuvendi i Kosovës mund të shkarkojë anëtarin nga Këshilli kur konsideron se ka ndonjë bazë për largim që parashihet me nenin 6.2 dhe 6.3 dhe 6.4 e që mund të zbatohet për anëtarin. Për të shkarkuar anëtarin nga Këshilli nevojitet shumica prej 60 për qind të votave të Kuvendit.

6.2. Anëtarët e Këshillit duhet t'i përmbahen ligjit të aplikueshëm në Kosovë dhe praktikave më të mira Evropiane dhe e kanë të ndaluar që të kërkojnë dhe pranojnë udhëzime gjatë përmbushjes së detyrave të tyre prej cilitdo autoritet tjetër përveç prej Këshillit.

6.3. Anëtarëve të Këshillit duhet tu ndalohet keqpërdorimi i pozitës së tyre për përfitim personal, të ndonjë pale apo entiteti përveç KPM-së. Anëtarët e Këshillit nuk pranojnë asnjë formë të kompensimit nga burime të tjera përveç buxhetit të KPM-së për kryerjen e detyrave të tyre në Këshill.

6.4. Shkarkimi i anëtarëve të Këshillit duhet të bëhet sipas këtyre kushteve:

- a. nëse anëtari nuk i përmbush kushtet sipas nenit 4.7, 6.2 dhe 6.3 të këtij ligji;
- b. nëse vërtetohet se në vazhdimësi dështon t'i përmbush detyrat e anëtarit të Këshillit; ose
- c. nëse anëtari shfrytëzon emërimin e vet për përfitime personale ose për përfitim të ndonjë pale a subjekti tjetër pos për KPM-në.

Procedurat e Këshillit
Neni 7

7.1. Anëtari më i vjetër i Këshillit thërret mbledhjen e parë të Këshillit brenda 30 dite pasi të jenë bërë emërimet dhe miratimet nga Kuvendi i Kosovës.

7.2. Këshilli, me shumicë votash, do të zgjedhë kryesuesin dhe zëvendës kryesuesin e vet nga anëtarët e Këshillit.

7.3. Mandati i kryesuesit dhe i zëvendës kryesuesit zgjatë një vit dhe cilido prej tyre mund të rizgjidhet me shumicën e votave të Këshillit.

7.4. Kryesuesi thërret mbledhjet e Këshillit së paku një herë në tre muaj. Sipas vlerësimit të kryesuesit ose me kërkesë e mbi gjysmës së anëtarëve, kryesuesi thërret mbledhjet, siç kërkohet nga Këshilli për t'i përmbushur funksionet e veta.

7.5. Kuorumi për mbajtjen e mbledhjeve dhe marrjen e vendimeve është prania e mbi gjysmës së anëtarëve të Këshillit.

7.6. Shefi Ekzekutiv ndjekë mbledhjet e Këshillit, si anëtar pa të drejtë vote.

7.7. Jo më vonë se tre muaj pas konstituimit, Këshilli duhet të përcaktojë rregulloren e punës, siç kërkohen për t'i përmbushur funksionet e veta në mënyrë të hapur dhe transparente.

PJESA C: ZYRA E SHEFIT EKZEKUTIV

Funksionet e Zyrës së Shefit Ekzekutiv Neni 8

8.1. Nën drejtimin e Shefit Ekzekutiv, Zyra e Shefit Ekzekutiv duhet të zbatojë të gjitha aspektet e politikës së transmetimit, siç përcaktohen nga Këshilli brenda kornizës së buxhetit të caktuar në pajtim me këtë ligj.

8.2. Zyra e Shefit Ekzekutiv mund t'i japë Këshillit rekomandime përkitazi me çështjet e politikës dhe çështjet lidhur me buxhetin dhe administratën.

8.3. Zyra e Shefit Ekzekutiv përgatit propozimin për buxhetin vjetor të KPM-së të cilin ia paraqet Këshillit të KPM-së për miratim. Buxheti duhet të sigurojë mjete të nevojshme për shpenzime administrative, shpenzime për personelin, shpenzimet e kapitalit, shpenzimet e programimit, në pajtim me procedurat e buxhetit të përcaktuara nga autoriteti kompetent i qeverisë për çështje fiskale. Administrimi i financave të KPM-së i nënshtrohet procedurave të revizionit të përcaktuara nga autoriteti kompetent i qeverisë për çështje fiskale.

8.4. Zyra e Shefit Ekzekutiv duhet që brenda kornizës së këtij ligji dhe të politikës së përcaktuar nga Këshilli, të përcaktoj procesin për vlerësimin e aplikacioneve për liçenca të transmetimit, rekomandon kushtet specifike teknike dhe joteknike në lidhje me nxjerrjen e liçencave, siç parashihen me këtë Ligj dhe t'i rekomandojë Këshillit sanksione përmes çdo mekanizmi të mundshëm sipas ligjit të zbatueshëm. Liçencat e lëshuara nga Komisioneri i Përkohshëm i Mediave para se të hyjë në fuqi ky ligj mbeten të vlefshme derisa të përfundojnë apo zëvendësohen nga një liçencë e KPM-së në pajtueshmëri me këtë ligj.

8.5. Zyra e kryeshefit ekzekutiv i rekomandon Këshillit një plan për ndarjen e frekuencave të transmetimit duke i marrë parasysh nevojat e komunitetit dhe kapacitetin e tregut. Zyra e kryeshefit ia rekomandon Këshillit për miratim kriteret për ndarjen e frekuencave të transmetimit në pajtim me kapitullin III të këtij Ligji.

8.6. Zyra e Shefit Ekzekutiv shqyrton kryerjen e detyrave vjetore të Transmetuesit Publik në mënyrë që të vërteton se Transmetuesi Publik i përmbush obligimet e veta. Të gjitha dokumentet që janë në lidhje me funksionin e Transmetuesit Publik, përfshirë buxhetin dhe cilido shqyrtim i kryerjes së detyrave - do të bëhet publik. Këshilli i KPM-së nëpërmjet Shefit Ekzekutiv, mund të kërkojë kontroll të menaxhimit dhe/apo financiar të transmetuesit publik, kur këtë e konsideron të arsyeshme dhe të mbështetur në fakte. Zyra e Shefit Ekzekutiv, të njëjtin shqyrtim vjetor e bënë për secilin Transmetues Privat që merr fonde publike. Përgjegjësitë dhe veprimet në asnjë mënyrë nuk duhet të dobësojnë pavarësinë e transmetuesit.

Shefi Ekzekutiv
Neni 9

9.1. Shefi Ekzekutiv është përgjegjës për të gjitha aspektet e menaxhmentit të Zyrës së Shefit Ekzekutiv në pajtim me politikën e përcaktuar nga Këshilli brenda kornizës së buxhetit të caktuar sipas këtij ligji. Shefi Ekzekutiv do të menaxhojë punët e përditshme të Zyrës së Shefit Ekzekutiv dhe është përgjegjës për menaxhimin financiar të KPM-së.

9.2. Këshilli e emëron Shefin Ekzekutiv pas shpalljes dhe nëpërmjet një procesi të hapur dhe konkurrues, në të cilin së paku dy të tretat e anëtarëve të Këshillit pajtohen për zgjedhjen e tij. Emërimi bëhet për një afat trevjeçar. Çdo emërim mund të ripërtërihet me pajtimin dhe vendimin e marrë nga së paku dy të tretat e anëtarëve të Këshillit.

9.3. Asnjë person nuk mund të jetë Shef Ekzekutiv nëse ai ose ajo:

- a. është në marrëdhënie aktive pune në shërbimin civil të Kosovës;
- b. mban një post të zgjedhur publik;
- c. është anëtar i organit ekzekutiv të një partie politike;
- d. ka interes financiar të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në telekomunikacion ose në industrinë e transmetimeve;
- e. ka qenë i dënuar pas një procesi gjyqësor në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtare, për një krim që përfshin dhunën ose pandershmërinë, për të cilën ai ose ajo nuk është liruar zyrtarisht ose sipas ligjit; ose
- f. është përfshirë në aktivitetet që janë në kundërshtim me funksionet e Këshillit.

9.4. Këshilli mund ta largojë nga posti Shefin Ekzekutiv, me pajtimin e së paku dy të tretat e anëtarëve të Këshillit, kur:

- a. Shefi ekzekutiv e humbë zotësinë juridike për të vazhduar ta mbajë postin në bazë të nenit 8.3;
- b. Këshilli konstaton që Shefi Ekzekutiv në mënyrë të dëshmuar dhe në vazhdimësi dështon t'i përmbush detyrat e tij/saj sipas këtij ligji.

9.5. Në rast se Shefi Ekzekutiv vdes, jep dorëheqje ose largohet nga posti, Këshilli emëron një anëtar të personelit të Zyrës së Shefit Ekzekutiv që ta kryejë detyrën përkohësisht, deri sa Këshilli ta zgjedhë Shefin e ri Ekzekutiv.

Personeli i Zyrës së Shefit Ekzekutiv
Neni 10

10.1. Shefi Ekzekutiv, në kuadër të buxhetit të KPM-së, e emëron personelin ashtu siç kërkohet, për t'i përmbushur përgjegjësitë e Zyrës së Shefit Ekzekutiv.

10.2. Shefit Ekzekutiv dhe stafit të tij i ndalohet të kërkojnë ose pranojnë instruksione në ushtrimin e detyrave të tyre nga ndonjë autoritet tjetër përveç Këshillit dhe Bordit të Ankesave për Media, vetëm nëse parashihet ndryshe me ligj.

10.3. Shefit Ekzekutiv dhe personelit u ndalohet shfrytëzimi i pozitës së tyre për përfitim personal ose për përfitim të ndonjë partie ose subjekti tjetër përveç KPM-së.

10.4. Shefi Ekzekutiv dhe personeli i Komisionit janë anëtarë të shërbimit civil. Kjo bëhet pa paragjykimin e ushtrimit të funksioneve të tyre në mënyrë të pavarur si punëtorë të KPM-së. Komisioni i punëson zyrtarët e tij sipas nevojës për të kryer me efekt funksionet e tyre në bazë të këtij ligji. Përzgjedhja e personelit duhet të bazohet në merita dhe aftësitë profesionale dhe ai proces duhet të realizohet në mënyrë të hapur, konkurruese dhe jodiskriminuese. Praktikrat e punës së personelit duhet të jenë në pajtueshmëri me ato të shërbimit civil dhe niveli i pagave duhet harmonizuar deri në masën më të madhe të mundshme me atë të shërbimit civil.

KREU III LIÇENCIMI I TRANSMETUESVE

PJESA A: APLIKACIONET PËR LIÇENCË TË TRANSMETIMIT DHE RIIPËRTËRITJA E TYRE

Liçenca e transmetimit Neni 11

11.1. Për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet liçenca për transmetim, të cilën e lëshon Komisioni.

11.2. Liçencat e transmetimit dhe ripërtëritja e tyre, përfshirë këtu transmetuesit dixhital dhe kabllorik bëhen për një afat shtatëvjeçar për radio dhe dhjetëvjeçar për televizion.

11.3. Liçencat e transmetimit të lëshuara nga Komisioneri i Përkohshëm i Mediave mbesin në fuqi deri atëherë kur KPM-ja të ketë një procedurë të drejtë dhe të hapur për dhënie e liçencës afatgjate të përcaktuar me këtë ligj. Me miratimin e një procesi afatgjatë të liçencimit nga Këshilli, të gjitha liçencat ekzistuese dhe të gjithë kandidatët e rinj të kualifikuar do të merren në konsiderim për liçencë afatgjatë nga Komisioni brenda gjashtë muajve nga dita e miratimit të procesit të liçensimit.

11.4. Liçencat nuk mund të shfrytëzohen dhe barten pa autorizimin dhe pa aprovimin paraprak me shkrim të KPM-së.

11.5. Transmetuesit e liçencuar duhet të veprojnë në përputhje me praktikrat më të mira Evropiane, në përputhje me politikat transmetuese dhe kushtet e caktuara nga KPM-ja.

Aplikimet për liçencat e transmetimit Neni 12

12.1. Aplikimet për liçencat e transmetimit do të bëhen në KPM përmes Zyrës së Shefit Ekzekutiv në përputhje me këtë Ligj dhe me procedurat që do të përcaktohen dhe publikohen

nga Këshilli. Për aplikimet për liçenca dhe për procedurat që janë zhvilluar lidhur me to kërkohet informacion që është i domosdoshëm për KPM-në, për të përcaktuar përshtatshmërinë e aplikantit me kushtet e përcaktuara në këtë ligj.

12.2. Liçenca e transmetimit mund t'i lëshohet vetëm individëve apo subjektit që përmbush kërkesat e parashikuara në këtë ligj dhe kriterëve të cilat KPM-ja mund t'i përcaktojë sipas një procedure të drejtë dhe të hapur të konkurrimit.

12.3. Liçenca e transmetuesit nuk i lëshohet ose nuk do të vazhdoj t'i jepet:

- a. partisë politike, grupit ose organizatës e cila menaxhohet nga individi i cili mban post të zgjedhur ose është anëtar i një organi ekzekutiv të një partie politike;
- b. Individit, ose subjektit i cili menaxhohet nga një individ, i cili është i dënuar në një proces në përputhje me standardet ndërkombëtare, për krime që kanë të bëjnë me dhunë apo mashtrime, të cilat nuk i janë falur ligjerisht atij ose asaj.

12.4. Zyra e Shefit Ekzekutiv, kur t'i bëjë rekomandimet Këshillit për liçencim, me rastin e vlerësimit të aplikacioneve të parashtruara për liçencat e transmetimit, do të marrë parasysh faktorët e mëposhtëm:

- a. natyrën dhe shkallën e burimeve financiare të aplikantit;
- b. realizueshmërinë financiare të propozimit të aplikantit;
- c. kapacitetin teknik të aplikantit për të ofruar transmetim cilësorë;
- d. nevojën për të siguruar program të shumëllojshëm për të gjithë qytetarët e Kosovës;
- e. nivelin në të cilën programi i ofruar i kontribuon zhvillimit të prodhimit të programit vetanak;
- f. aplikacionet konkurrense dhe
- g. aplikacionet e tjera të pranuar.

12.5. Zyra e Shefit Ekzekutiv duhet të mbajë një regjistër të liçencave të transmetimit, ku përfshihen kushtet e aplikueshme për secilën liçencë. Ai regjistër do të jetë në dispozicion për kontrollim publik.

Lëshimi i liçencave të transmetimit

Neni 13

13.1. Kur Këshilli propozon të lëshojë mëtej liçenca të transmetimit, ai do ta publikojë gjerësisht një njoftim për këtë qëllim përmes Zyrës së Shefit Ekzekutiv. Në njoftim përfshihet i tërë informacioni përkatës për liçencat e propozuara të transmetimit, procesi për dorëzimin e aplikacioneve, informacioni që kërkohet nga aplikantët, metodologjia dhe kriteret për vlerësimin e aplikacioneve për liçencat e transmetimit, dhe çfarëdo tarife të aplikueshme për aplikacionin.

13.2. KPM-ja, përmes licencimit, duhet që të ndajë frekuenca të mjaftueshme për Transmetuesin Publik për t'i mundësuar që t'i ofroj popullsisë së Kosovës një mbulim radio televiziv deri në masën maksimale të mundshme.

13.3. Këshilli, brenda njëqind e njëzet (120) ditësh pas përfundimit të datës për aplikim, vendos mbi bazat e konkurrimit se a do t'ia lëshojë liçencën e transmetimit një aplikanti, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 11 dhe 12. Në rrethana të jashtëzakonshme, Këshilli,

me propozim të Zyrës së e Shefit Ekzekutiv, mund ta zgjasë kufizimin prej njëqind e njëzet (120) ditësh. Kur data e përfundimit zgjatet, Zyra e Shefit Ekzekutiv i informon të gjithë aplikantët dhe publikun për zgjatjen e afatit dhe arsyet për këtë.

13.4. Zyra e Shefit Ekzekutiv, aplikantëve dhe palëve të interesuara, u ofron mundësinë efektive që të bëjnë paraqitjen e tyre para Këshillit.

Procesi i liçencimit do të jetë i drejtë dhe transparent Neni 14

14.1. Procesi i vlerësimit të aplikacioneve për liçencë transmetimi dhe ripërtrirja e liçencave duhet të jetë i drejtë dhe transparent.

14.2. Vendimet e KPM-së mbi refuzimin ose mosripërtrirjen e licencës për transmetuesin duhet të jenë të arsyetuara me shkrim dhe ato u dorëzohen aplikantëve nëpërmjet Zyrës së Shefit Ekzekutiv.

Ripërtëritja e liçencave Neni 15

15.1. Përveç rasteve kur Këshilli me rekomandimin e kryeshefit ekzekutiv, konsideron se licenca nuk duhet të ripërtëritet për shkak të shkeljes së dispozitave materiale nga ana e transmetuesit privat për sa u përket kushteve të liçencimit transmetuesi ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga Zyra e kryeshefit ekzekutiv brenda dymbëdhjetë (12) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese.

15.2. Kur ripërtërihet liçenca Këshilli me rekomandimin e Zyrës së Shefit Ekzekutiv, mund të bëjë ndryshime në kushtet e liçencës, në varësi të votave pozitive të më shumë se gjysma e anëtarëve të Këshillit.

Tarifat vjetore të liçencës Neni 16

16.1. Me rekomandimin e Shefit Ekzekutiv, Këshilli cakton një skemë për tarifave të liçencës, për kategori të ndryshme të liçencave të transmetimit që do të paguhet për çdo vit nga të liçencuarit. Në caktimin e orarit, Zyra e Shefit Ekzekutiv i merr parasysh kushtet mbizotëruese dhe ato të projektuara të tregut. Tarifa e liçencës do të jetë e njëjtë në kuadër të çdo kategori të liçencave. Orari i tarifave i paraqitet Këshillit për aprovim.

16.2. Zyra e Shefit Ekzekutiv e rishikon dhe mund të bëjë ndryshime në orarin e tarifave të liçencave çdo dy (2) vjet.

16.3. Tarifave vjetore të liçencave mblidhen nga Zyra e Shefit Ekzekutiv . Paratë e mbledhura do të depozitohen në tërësi në një xhirollogari të KPM-së që caktohet nga autoriteti qeveritar kompetent për çështjet fiskale. Zyra e Shefit Ekzekutiv do të jetë përgjegjëse për mirëmbajtjen e shënimeve për të gjitha pagesat e tarifave të liçencave. Ky proces do t'u

nënshtrohet procedurave normale të revizionit, ashtu siç parashihen nga autoriteti qeveritar kompetent për çështjet fiskale.

Reklamimi Neni 17

17.1. Njëri nga funksionet e KPM-së është mbikëqyrja e procesit tranzitor me anë të të cilit financimi për transmetuesin publik sigurohet nëpërmes parapagimit për transmetues. Në këtë tranzicion, mbështetja në fondet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK) dhe reklamimi do të zvogëlohet me rritjen e nivelit të inkasimit të parapagimit për Transmetuesin Publik me pikësynim eliminimin nga BKK-ja si burim i të hyrave dhe minimizim apo përfundimisht eliminimin (nëse është i zbatueshëm) e reklamimit, përfshirë sponsorizimin dhe teleshopingun, si burim i të hyrave. KPM-ja e drejton tranzicionin në mënyrën që nuk rrezikon aftësinë e transmetuesit publik apo privatë për të funksionuar si entitete të qëndrueshme. Po ashtu do të drejtojë përdorimin e reklamimit për klauzolat në vijim.

17.2. KPM-ja duhet të vendos një kod etik të reklamimit për transmetuesit në pajtueshmëri me praktikat më të mira Evropiane.

17.3. KPM-ja do të jetë përgjegjëse për t'u siguruar se transmetuesi publik nuk vendos tarifa të reklamimit që janë më të ulëta se nivelet mbizotëruese në treg të ofruara nga transmetuesit privatë për reklamim të ngjashëm. KPM-ja, në bazë të nevojës, do të nxjerrë rregullore të veçanta për të parandaluar praktikat e padrejta apo monopoliste të biznesit nga cilido subjekt transmetues.

17.4. Gjatë caktimit të politikës për qasjen e transmetuesit publik në reklamim, duke përfshirë edhe sponsorimet, Këshilli duhet të vendos kufijtë në atë mënyrë që nuk dëmton aftësinë për funksionim të mirë si të transmetuesit publik, po ashtu edhe të transmetuesve privatë. Kufizimet në reklamim do të përfshijnë minutazhin ditor, minutazhin për një orë, minutazhin gjatë transmetimit në kohën më të shikuar si dhe kufizimet e tjera, të cilat Këshilli i konsideron si të përshtatshme.

Kërkesat për raportim Neni 18

18.1. Transmetuesi duhet të paraqes raport vjetor pranë KPM-së në të cilin përfshihet informacioni përkitazi me programin dhe veprimin në përputhje me kushtet e licencës, një raport financiar të detajuar dhe informacione të tjera të parapara me Ligj. Raportet vjetore paraqiten jo më vonë se 90 ditë pas përfundimit të vitit, dhe i dorëzohen nëpërmjet Zyrës së Shefit Ekzekutiv KPM-së.

18.2. Zyra e Shefit Ekzekutiv mund të kërkojë informacion të mëtejshëm nëse konsideron se informacioni i paraqitur në raportet vjetore është i paplotë.

18.3. Përveç në rastet kur me ligj kërkohet të veprohet ashtu, KPM-ja nuk do t'ia publikojë asnjë personi informacionin e ndjeshëm komercial që paraqitet në raportin vjetor të transmetuesit.

PJESA B: SHKELJA E KUSHTEVE TË LIÇENCËS DHE SANKSIONET

Shkelja e kushteve të liçencës Neni 19

19.1. Zyra e Shefit Ekzekutiv do t'i monitorojë transmetuesit dhe mund të iniciojë dhe të pranojë ankesa përkitazi me mosveprimin në përputhje me kushtet e liçencës, kodeve të sjelljes, dhe akteve tjera juridike në pajtueshmëri me këtë ligj.

19.2. Zyra e Shefit Ekzekutiv do t'i hetojë ankesat që pohojnë shkeljen e kushteve të liçencës, kodeve të sjelljes, dhe akteve tjera juridike në pajtueshmëri me këtë ligj, përveç në rastet kur konsideron se ankesa është qartazi e pabazuar ose joserioze.

19.3. Zyra e Shefit Ekzekutiv e njofton transmetuesin me shkrim për çdo pohim lidhur me shkeljen e kushteve të liçencës, kodeve të sjelljes, dhe akteve tjera juridike në pajtueshmëri me këtë ligj, dhe siguron që transmetuesi të ketë mundësi të arsyeshme për të bërë prezantim dhe për të paraqitur dëshmi.

19.4. Pas përfundimit të hetimit, Zyra e Shefit Ekzekutiv e informon Këshillin për konstatimet e veta dhe bën rekomandime. Këshilli e jep vendimin me shkrim, krahas indikacioneve për çfarëdo sanksionesh që duhet të shqiptohen. Kundër vendimeve të marra transmetuesi ka të drejtë të kërkojë rishqyrtim nga Bordi i Ankesave për Media.

Sanksionet Neni 20

20.1. Me rekomandimin e Zyrës së Shefit Ekzekutiv, Këshilli mund të lëshojë vërejtje me shkrim ose t'ia shqiptojë një ose më shumë prej sanksioneve në vijim transmetuesit për shkelje të kushteve të liçencës, kodeve të sjelljes, dhe akteve tjera juridike në pajtueshmëri me këtë ligj:

- a. t'i urdhërojë transmetuesit që t'i transmetojë publikisht detajet e natyrës dhe shkallës së shkeljes së kushteve të liçencës, kodeve të sjelljes, dhe akteve tjera juridike në pajtueshmëri me këtë ligj;
- b. të kërkojë nga transmetuesi që të transmetojë korrigjimin ose të kërkojë falje përmes transmetimit;
- c. t'i vendosë një gjobë në vlerë jo më pak se 500 euro dhe jo më shumë se 50.000 euro;
- d. (d) të kërkojë pezullimin e një pjese ose gjithë orarin e programit të transmetuesit për një periudhë të saktësuar kohe;
- e. t'ia ndryshojë kushtet e liçencës së transmetuesit;
- f. t'ia ndërprejë apo refuzoj vazhdimin liçencën e transmetimit.

20.2. Vendimi i Këshillit për të vënë një apo më shumë sanksione të paraqitura në nenet më lartë zbatohet atëherë kur:

- a. asnjë ankesë e pranueshme kundër vendimit të Këshillit nuk është bërë brenda periudhës kohore të lejuar për ankesa në Bordin e Ankesave për Media në bazë të nenit 24.1, dhe
- b. një ankesë e pranueshme paraqitet brenda afatit të caktuar dhe vendimi i nxjerrë nga Bordi i Ankesave për Media e mbështet vendimin e Këshillit. Megjithatë në raste të veçanta, nëse vendoset nga Këshilli, sanksioni i vënë duhet të hyjë në fuqi menjëherë. Ankesa nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit.

20.3. Kur transmetuesi nuk e respekton sanksionin, Këshilli mund të marrë masa të nevojshme të lejuara nga ligji i zbatueshëm për të vënë në zbatim këtë sanksion përmes Zyrës së Shefit Ekzekutiv.

20.4. Gjjobat që paguhen sipas nenit 20.1 (c) do të mblidhen nga Zyra e Shefit Ekzekutiv në emër të Fondit të Konsoliduar të Kosovës. Paratë e mbledhura depozitohen në tërësi si të ardhura të përgjithshme në një xhirollogari të Qeverisë që caktohet nga autoriteti qeveritar kompetent për çështje fiskale. Zyra e Shefit Ekzekutiv është përgjegjëse për mirëmbajtjen e regjistrave për të gjitha pagesat e gjobave të licencave. Ky proces u nënshtrohet procedurave normale të revizionit, ashtu siç parashihet nga autoriteti qeveritar kompetent për çështje fiskale.

20.5. Kushdo që operon pa leje transmetuese valide i konfiskohet aparatura përkatëse për transmetim. Subjekti i tillë transmetues nuk mund të ankohet tek Bordi i Ankesave për Media.

20.6. Sanksionet e përcaktuara në nenet 20.1 (d), (e) dhe (f) nuk vlejnë për transmetuesin publik, por nëse sipas mendimit të Këshillit dhe pas rekomandimit të Zyres së kryeshefit ekzekutiv transmetuesi publik i shkelë kushtet e tij të licencimit, kodet e sjelljes dhe aktet tjera ligjore në përputhje me këtë Ligj, Këshilli mund të bëjë rekomandime të cilat i konsideron të nevojshme.

20.7. Të gjitha vendimet e Këshillit të nxjerra sipas këtij neni, duke përfshirë çfarëdo sanksionesh të shqiptuara, do të publikohen para opinionit të gjerë.

20.8 Me kërkesë të KPM-së agjencitë për zbatimin e ligjit në Kosovë ndihmojnë në zbatimin e vendimeve të tij.

KREU IV THEMELIMI I BORDIT I ANKESA PËR MEDIA

Bordi për Ankesa të Mediave Neni 21

21.1. Me këtë ligj themelohet Bordi i Ankesave për Media (tash e tutje “Bordi i Ankesave”).

21.2. Bordi i Ankesave është i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij.

21.3. Bordi i Ankesave gjykon ankesat e palëve që drejtpërdrejtë i nënshtrohen vendimit përsa i përket:

- a. dhënies, refuzimit, mosripërtërirjes ose revokimit të lejes transmetuese;
- b. vënies ose ndryshimit të kushteve të lejes së transmetimit, me përjashtim të kushteve që kanë të bëjnë me caktimin e frekuencave apo kritereve të tjera teknike;
- c. shqiptimit të sanksioneve; dhe
- d. çështjeve tjera të ngjashme që mbështeten në urdhëresat administrative dhe rregulloren.

21.4. Diskutimet dhe vendimet e Bordit të Ankesave duhet të:

- a. jenë në pajtim me standardet ndërkombëtarisht të pranuar të transmetimit dhe të drejtave njerëzore;
- b. jenë në përputhje me synimet dhe qëllimet e rezolutës përkatëse të Këshillit të Sigurimit; dhe
- c. të respektojnë demokracinë dhe mbizotërimin e ligjit dhe të mbrojnë lirinë e shprehjes.

21.5. Bordi i Ankesave mund të përkrahë, ndryshojë ose shfuqizojë çdo vendim të Këshillit që ka të bëjë me ankesën.

Përbërja e Bordit të Ankesave Neni 22

22.1. Bordi i Ankesave përbëhet prej tre anëtarëve, dy prej të cilëve duhet të jenë banorë të Kosovës (më tej “anëtarët vendorë të bordit”) dhe njëri prej tyre duhet të jetë ndërkombëtar.

22.2. Personat e zgjedhur për t’u emëruar si anëtarë të Bordit për Ankesa duhet të kenë njohuri relevante dhe përvojë si dhe të kenë kualifikimin e kërkuar për t’u emëruar në zyrën ligjore apo që të jenë këshilltar ligjor të kualifikuar.

22.3. Anëtari ndërkombëtar i Bordit të Ankesave emërohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, duke marr parasysh rekomandimet e Zëvendës Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Ndërtimin e Institucioneve.

22.4. Anëtarët vendor të Bordit të Ankesave për Media caktohen nga Gjykata Supreme e Kosovës, dhe emërohen nga Kuvendi i Kosovës pas kërkesës publike të emërimeve nga Këshilli.

22.5. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm emëron njërin nga anëtarët si Kryetar të Bordit të Ankesave.

22.6. Pas arritjes së statusit përfundimtar të Kosovës, Bordi i Ankesave për Media përbëhet vetëm nga vendorët.

22.7. Asnjë person nuk mund të jetë anëtar i Bordit të Ankesave nëse ai apo ajo:

- a. Është në punësim aktiv në shërbimin civil të Kosovës;
- b. Mban zyre të dalë nga zgjedhjet;
- c. Është anëtar i organit ekzekutiv të një partie politike;
- d. Ka interes financiar të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në industrinë e telekomunikacionit apo të transmetimit; ose
- e. Është dënuar, pas një procesi përkatës në pajtim me standardet e pranueshme ndërkombëtarisht, për krim ku përfshihet dhuna ose pandershmëria, për çka ai apo ajo nuk janë falur zyrtarisht apo legalisht.

22.8. Anëtarëve të Bordit të Ankesave u ndalohet të kërkojnë ose pranojnë instruksione nga ndonjë autoritet për ushtrimin e detyrave të tyre.

22.9. Anëtarëve të Bordit të Ankesave u ndalohet shfrytëzimi i pozitës së tyre për përfitime personale, apo përfitime të ndonjë pale apo entiteti.

22.10. Emërimet për në Bordin e Ankesave bëhen për periudhën prej tri (3) vjetësh. Anëtarët e Bordit të Ankesave mund të rrimërohen për një apo më shumë mandate në pajtim me procedurat e vendosura në nenin 22.

Shkarkimi nga Bordi i Ankesave dhe sjellja e anëtarëve Neni 23

23.1. Duke marr parasysh rekomandimet e Zëvendës Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Ndërtimin e Institucioneve, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të largojë anëtarin ndërkombëtar nga Bordi i Ankesave kur konsideron se arsyet për largim të dhëna në nenin 23.3 kanë të bëjnë me atë anëtar.

23.2. Kuvendi i Kosovës me shumicë votash të deputetëve të Kuvendit, mund të rekomandojë largimin e një anëtari vendor të Bordit të Mediave për ankesa nga ana e Gjykatës Supreme. Anëtari vendor i Bordit të Ankesave për Media mund të largohet nga ana e Gjykatës Supreme kur ekzistojnë shkaqet për largim, siç përcaktohen në nenin 23.3 për atë anëtar.

23.3. Arsyet për largimin e një anëtari të Bordit të Ankesave duhet të jenë:

- a. anëtari bëhet i papërshtatshëm për të qenë anëtar më tutje, sipas nenit 22.7; ose
- b. anëtari dështon në ushtrimin e detyrave të tij në mënyrë efektive, ose sillet në mënyrë që nuk është në pajtueshmëri me rregulloren e tanishme ose me parimet e përfshira në rezolutat përkatëse të Këshillit të Sigurimit.

23.4. Duke marrë parasysh rekomandimet e Zëvendës Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Ndërtimin e Institucioneve, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm emëron anëtarin e ri për të zëvendësuar ndonjë anëtar ndërkombëtar i cili ka

vdekur, ka dhënë dorëheqje, ose është shkarkuar nga Bordi i Ankesave. Anëtarit i cili emërohet shërben për pjesën e mbetur të mandatit të anëtarit i cili është zëvendësuar.

23.5. Për të zëvendësuar ndonjë anëtar vendor i cili ka vdekur, ka dhënë dorëheqje apo është larguar, Gjykata Supreme e Kosovës emëron anëtarin e ri, sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj. Anëtarit i emëruar për plotësimin e vendit të lirë, vazhdon pjesën e mbetur të mandatit të anëtarit i cili është zëvendësuar.

Procedurat e Bordit të Ankesave Neni 24

24.1. Kryetari i Bordit të Ankesave thërret takimin e parë të Bordit të Ankesave më së largu 30 ditë pas caktimit të të gjithë anëtarëve të Bordit.

24.2. Bordi i Ankesave duhet që të:

- a. Miratojë me vendim unanim dhe të publikojë një kornizë procedurale për seancat, e cila do të garantoj seanca të ndershme dhe të paanshme në pajtim me nenin 20.4. Kjo kornizë duhet të përfshijë edhe dispozitat mbi procedurën e parashtrimit të ankesave, hulumtimet nga ana e Bordit të Ankesave si dhe llojin e provave që mund të jenë të pranueshme gjatë seancave. Kjo informatë duhet të bëhet publike. Këto rregulla, ndonjë rregull e re apo ndryshim, mund të ndryshohen apo të zëvendësohen me votim unanim të Bordit të Ankesave për Media dhe duhet të bëhen publike.

24.3. Bordi i Ankesave për Media mund t’ia delegojë funksionet e tij Zyrës së Shefit Ekzekutiv në lidhje me pranueshmërinë e ankesave dhe materialit dëshmues, nën mbikëqyrjen e Bordit të Ankesave për Media

Dorëzimi i Ankesës Neni 25

25.1. Ankesat i parashtrohen Bordit të Ankesave brenda tridhjetë ditësh nga nxjerrja e vendimit të paraqitur në nenin 20.3. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 24.2(a).

25.2. Bordi i Ankesave për Media do t’i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të Këshillit, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e Këshillit gjatë marrjes së vendimit. Bordi i Ankesave për Media mundet që, pa dëgjim dhe pas rekomandimit të shkruar nga ana e Shefit Ekzekutiv, të hedh poshtë ankesat të cilat nuk janë të bazuara në njërin nga këto dy mundësi, apo të cilat, nën dispozitat e vendosura nga Bordi i Ankesave për Media në pajtueshmëri me Nenin 24.2 janë të papranueshme sepse janë të pavlera, keqdashëse apo të pabaza.

Vendimet e Bordit të Ankesave
Neni 26

26.1. Bordi i Ankesave për Media lidhur me ankesat e parashtruara vendos me vendim me shkrim. Ky vendim u dorëzohet palëve dhe publikohet nëpërmjet Zyrës së Shefit Ekzekutiv.

26.2. Vendimet e Bordit të Ankesave janë përfundimtare dhe u nënshtrohen vetëm shqyrtimit procedural të Gjykatës Supreme të Kosovës në pajtim me ligjin në fuqi.

KREU V
FINANCIMI I KPM DHE BORDIT TË ANKESAVE PËR MEDIA

Burimet e financimit
Neni 27

KPM-së dhe organeve të tij i ndahen mjete të mjaftueshme nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për t'ua mundësuar kryerjen e funksioneve të tyre në tërësi dhe në mënyrë të pavarur. Autoritetet publike nuk shfrytëzojnë procesin buxhetor për ndarjen e fondeve nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës në mënyrën që do të ndërhynte në pavarësinë e KPM-së. Pagesat e licencimit që mbliidhen në përputhje me nenin 16 e plotësojnë financimin buxhetor të ndarë nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

Mbështetja financiare
Neni 28

KPM dhe Bordi i Ankesave për Media mund të mbështeten nga donacione plotësuese dhe mjete materiale të dhëna drejtpërdrejt KPM-së dhe Bordi i Ankesave për Media, donacione të cilat duhet të regjistrohen në llogaritë vjetore të KPM, përkatësisht Bordi i Ankesave për Media së bashku me përdorimin e këtyre donacioneve për funksionimin e organizatave. Resurset e donatorëve nuk ndikojnë në pavarësinë e KPM-së apo në të drejtën e tij në fonde sipas nenit 27.

KREU VI
DISPOZITAT E PËRKOHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

Dispozitat e Kalimtare
Neni 29

29.1. Funksionet dhe kompetencat të dhëna Komisionerit të Përkohshëm për Media në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/36 të datës 17 qershor 2000 mbi Liçencimin dhe Rregullimin e Mediave Elektronike në Kosovë do të vazhdojë të mbesë në fuqi deri në kohën e themelimit të Këshillit dhe emërimit të Shefit Ekzekutiv në bazë të procedurave të ligjit aktual.

29.2. Funksionet dhe kompetencat që i caktohen Bordit për Ankesa të Mediave, të themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr.2000/36 vazhdojnë të realizohen nga ai Bord për ankesa i mediave deri në emërimin e të tre anëtarëve të Bordit për ankesa të mediave sipas nenit 22 të

këtij Ligjit dhe deri në kohën kur Bordi të ketë miratuar rregulloren e punës, regjistrin dhe pranimin në pajtim me nenin 24 të këtij Ligji.

29.3. Personeli i Zyrës së Komisionerit të Përkohshëm për Media në kohën e aprovimit të këtij ligji do të shndërrohet në personel të Zyrës së Shefit Ekzekutiv nga neni 10 i këtij Ligji.

29.4. Rregullat, kodet dhe procedurat e përcaktuara nga Komisioneri i Përkohshëm për media mbesin në fuqi derisa të ndryshohen, të zëvendësohen apo të anulohen nga Komisioni i përkohshëm për media në pajtim me këtë ligj.

Ligji i aplikueshëm
Neni 30

Ky ligj shfuqizon çdo dispozitë në ligjin e aplikueshëm që nuk është në përputhje me të.

Hyrja në fuqi
Neni 31

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës, dy (2) muaj pasi të shpallet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Ligji Nr. 02/L-15
21 prill 2005

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

akademik Nexhat Daci